

Abstrakt

Ideja për hartimin e Kartës për të Drejtat Themelore u formua gjatë Presidencës Gjermane në Unionin Evropian, në fillim të vitit 1999. Këshilli Evropian i vitit 1999 ishte ai që ndërmori iniciativën për hartimin e një Karte të të Drejtave Themelore për Unionin Evropian. Ky zhvillim erdhi pas shumë vitesh diskutime nëse UE-ja duhet të miratonte KEDNJ-në ose duhet të kishte Kartën e vet të të drejtave themelore të njeriut. Traktati i Lisbonës e bën Kartën e të Drejtave Themelore në Unionin Evropian të detyrueshme dhe merr status të njëjt si Traktatet themeluese të Unionit nëpërmjet modifikimit të nenit 6 të TUE, pavarësisht se nuk është pjesë e traktatit. Kjo do të thotë se ajo duhet të respektohet nga institucionet e Unionit dhe Shtetet Anëtare të UE-së gjatë zbatimit të ligjit të Unionit Evropian. Të drejtat themelore të përfshira në Kartën e të Drejtave Themelore mund të pohohen në procedurat para Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, e cila është përgjegjëse për zbatimin e drejtë të Kartës së të Drejtave Themelore.

Synimi i Kartës ishte t'i bënte më të qarta të drejtat ekzistuese për qytetarët evropianë, për t'i përshatur me zhvillimin e shoqërisë, përparimin shoqëror si dhe zhvillimet shkencore e teknologjike, duke i bërë këto të drejta më të dukshme. Gjithashtu konfirmon se të drejtat e njeriut janë të pandashme, të ndërlidhura me njëra-tjetrën dhe të pavarura. Karta përfshin të gjitha të drejtat e parashikuara nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e miratuar nga Këshilli i Evropës në vitin 1950, të drejtat e përcaktuar nga Karta Sociale Evropiane, e miratuar nga Këshilli i Evropës më 1961, e rishikuar më 1996, si dhe të drejtat dhe parimet që rrjedhin nga traditat e përbashkëta kushtetuese të të gjithë shteteve anëtare, nga praktika e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë dhe nga konventat e tjera ndërkombëtare në lidhje me të drejtat e njeriut. Të drejta si: të drejta politike, civile, sociale dhe ekonomike.

Fjalët kyçe: Unioni Evropian, Karta e të Drejtave Themelore, Gjykata e Drejtësisë, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, të drejtat politike, sociale dhe ekonomike